

FTESË PËR OFERTË

Emri: Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
Adresa: Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë
E-mail: infoacfdalbania@gmail.com
Afati i dorëzimit të ofertës: **12 Shkurt 2024**

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes po zbaton projektin ‘Vlerëso-Fuqizo-Vepro: stafe sociale më të fuqizuara përballë shërbimeve të kujdesit social, për fëmijët me AK, në Bashkinë Kavajë’, në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të organizojë një aktivitet ku do të bëhet e mundur identifikimi i fëmijëve me AK në qytetin e Kavajës dhe grupi që do të ngrihet për angazhimin në terren do të duhet që të takohet me prindërit e këtyre fëmijëve, për këtë arsye është i nevojshëm shërbimi refreshments për pjesëmarrësit në këto takime.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **12/02/2024**, në adresën e e-mailit: infoacfdalbania@gmail.com ose në adresën postare Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/shërbimit/	Çmimi/njësi Me TVSH
1.	Refreshments për 15 persona për 5 takime (/pije/kafe/biskota)	

Specifikime të përgjithshme teknike:

Refreshment për deri në 15 pjesmarrës gjithsej për 5 takime (total 75 persona), duke pëfshirë /pije/kafe/biskota do të ofrohen nga subjekti fitues në ambjentet e organizimit të takimeve, në bashkinë Kavajë.

Do të organizohen gjithësej 5 takime, të shpërndarë në 8(tetë) muaj që do të zhvillohet projekti.

Shërbimi duhet të jetë cilësor dhe të ofrohet në datën dhe orën e kërkuar dhe dakordësuar. Nga subjekti kërkohet një person, i cili do të shërbejë për pjesëmarrësit. Produktet e ofruara duhet të jenë të freskëta për konsum.

Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën 15 Shkurt 2024 – 1 Shtator 2024. Datat specifike do të përcaktohen në kontratën e lidhur me subjektin fitues

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Kavajë;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës infoacfdalbania@gmail.com brenda datës 12/02/2024 ose në adresën postare Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë.

Nuk pranohen ofertat dorazi.

- 4) PAGESA e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL (LEKE) dhe TVSH-ja të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit (NIPT);
- 2) Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër;
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

